

## AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

### I

#### ZYRES LIGJORE "RAKIPI & PARTNERS"

Sot ne daten 25 Qershor 2020 ne Tirane, prane selise se Shoqerise "Rakipi & Partners", u mblodhen ortaket e meposhtem :

**Z. Arben RAKIPI**, i biri i Shefqetit, lindur ne Tirane me 08.07.1961, banues po aty, Rruga "Pjeter Bogdani", pall. 13/4, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me nr. Personal G10708089M.

**Z. Jon RAKIPI**, i biri i Arbenit, lindur me date 08.07.1993 ne Tirane, identifikuar me nr. Personal J30708054C , perfaqesuar ne kete mbledhje nËpËrmjet ProkurËs sË Posaqme me Nr. 7128 Rep. dhe Nr. 2301 Kol, dt.02.11.2019, nga Znj. Vilma Rakipi.

**Z. Ermir BETA**, i biri i Veros, lindur ne Patos me date 14.04.1982, banues ne Tirane, Rruga "Mine Peza", madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar identifikuar me nr. Personal I20414067G .

**Znj. Romina ZANO** (Lleshi), e bija e Perparimit, lindur ne Durres me date 08.06.1990, banuese ne Tirane, Rruga "Ded Gjo Luli" nr.54, madhore me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me nr. Personal J05608091K .

Bazuar ne parashikimet dhe ne perputhje te plote me Ligjin me Nr.55/2018 "Per Profesionin e Avokatit ne Republiken e Shqiperise" si dhe me Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, kane perpiluar si me poshte Statutin dhe Aktin e Themelimit te Zyres Ligjore "Rakipi & Partners" sh.p.k.

#### I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME.

Zyra Ligjore "Rakipi & Partners" sh.p.k. bazohet ne legjislacionin shqiptar qe rregullon poziten juridike te subjekteve te tilla. Ky statut rregullon marrdheniet juridike ndermjet themeluesve te Zyres, te drejtat e detyrimet e tyre, aksesin e te tretteve prane kesaj zyre dhe menyren e aplikimit te tyre per partneritet, llojin e partneritetit, rekrutimin apo punesimin e te asociuarve, menyren e bashkepunimit me subjekte te tjere private apo shteterore, kohezgjatjen e veprimtarise, kriteret e karrieres brenda Zyres nga te interesuarit etj.

The image shows three handwritten signatures in blue ink. The first signature on the left is partially cut off. The middle signature is more legible and appears to be 'Ermir BETA'. The third signature on the right is a stylized, circular signature.

**NENI 1**  
**Objekti i Veprimtarise se Zyres**

Zyra do te kete si objekt kryesor te aktivitetit se saj veprimet e meposhtme :

1. Keshilla per ceshtje ligjore, civile, penale, administrative, tatimore e financiare;
2. Pergatitje e kerkesave te ndryshme derguar institucioneve publike apo personave te trete private;
3. Pergatitje te kerkesave ankimore kunder vendimeve gjyqesore, akteve te prokurorit, organeve te arbitrazhit apo te administrates shtetore ne pergjithesi;
4. Pergatitjen e dokumentacionit per personat juridike;
5. Perpilimin e akteve qe duhen te vertetohen perpara noterit;
6. Hartimin e kontratave apo marreveshjeve te tjera me pale private ose publike;
7. Pjesmarrjen si mbrojtës gjate gjithë fazave te procedimit penal;
8. Perfaqesimin e paleve gjate proceseve civile, administrative etj;
9. Perpilimin e studimeve apo dokumenteve te tjere teorike ne lidhje me fushat te ndryshme te se drejtes;
10. Organizimin e kurseve trajnues per juriste te rinj apo te interesuar te tjere ne perputhje me te drejtat e marra nga institucioneve publike;
11. Ndermjetesimin e zgjidhjes se konflikteve apo mosmarreveshjeve te ndryshme;
12. Menaxhimin e levizjes se lojtareve te futbollit sipas licences se marre nga autoritetet kompetente ;
13. Ne te gjitha rastet e tjera te parashikuara nga legjislacioni ;

**NENI 2**  
**Emri, Vula dhe Selia e Zyres**

2.1. Zyra eshte person juridik privat dhe vepron si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Ajo do te paraqitet ne qarkullim me emrin “Zyra Ligjore “Rakipi &Partners”, ose shkurt “R&P” sh.p.k.

2.2. Zyra ne korrespondencen dhe vulen e saj mund te perdore edhe emrin ne gjuhen angleze LAW OFFICE “Rakipi& Partners”.

2.3. Vula e zyres është në formë rrethi. Formohet nga logo e shoqërisë në mes, e cila rrethohet nga shkrimi “Rakipi&Partners” në pjesën e sipërme dhe “Zyra Ligjore” në pjesën e poshtme.

2.4. Vendndodhja e zyres eshte Rruga “Ibrahim Rugova”, pallatet “Green Park Tower”, Kulla 1, Kati 11, Ap.54, Tirane.



**NENI 1**  
**Objekti i Veprimtarise se Zyres**

Zyra do te kete si objekt kryesor te aktivitetit se saj veprimet e meposhtme :

1. Keshilla per ceshtje ligjore, civile, penale, administrative, tatimore e financiare;
2. Pergatitje e kerkesave te ndryshme derguar institucioneve publike apo personave te trete private;
3. Pergatitje te kerkesave ankimore kunder vendimeve gjyqesore, akteve te prokurorit, organeve te arbitrazhit apo te administrates shtetore ne pergjithesi;
4. Pergatitjen e dokumentacionit per personat juridike;
5. Perpilimin e akteve qe duhen te vertetohen perpara noterit;
6. Hartimin e kontratave apo marreveshjeve te tjera me pale private ose publike;
7. Pjesmarrjen si mbrojtes gjate gjithë fazave te procedimit penal;
8. Perfaqesimin e paleve gjate proceseve civile, administrative etj;
9. Perpilimin e studimeve apo dokumenteve te tjere teorike ne lidhje me fushat te ndryshme te se drejtes;
10. Organizimin e kurseve trajnues per juriste te rinj apo te interesuar te tjere ne perputhje me te drejtat e marra nga institucioneve publike;
11. Ndermjetesimin e zgjidhjes se konflikteve apo mosmarreveshjeve te ndryshme;
12. Menaxhimin e levizjes se lojtareve te futbollit sipas licences se marre nga autoritetet kompetente ;
13. Ne te gjitha rastet e tjera te parashikuara nga legjislacioni ;

**NENI 2**  
**Emri, Vula dhe Selia e Zyres**

2.1. Zyra eshte person juridik privat dhe vepron si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Ajo do te paraqitet ne qarkullim me emrin “Zyra Ligjore “Rakipi & Partners”, ose shkurt “R&P” sh.p.k.

2.2. Zyra ne korrespondencen dhe vulen e saj mund te perdore edhe emrin ne gjuhen angleze LAW OFFICE “Rakipi& Partners”.

2.3. Vula e zyres është në formë rrethi. Formohet nga logo e shoqërisë në mes, e cila rrethohet nga shkrimi “Rakipi&Partners” në pjesën e sipërme dhe “Zyra Ligjore” në pjesën e poshtme.

2.4. Vendndodhja e zyres eshte Rruga “Ibrahim Rugova”, pallatet “Green Park Tower”, Kulla 1, Kati 11, Ap.54, Tirane.





**NENI 3**  
**Regjimi Juridik i Zyres**

3.1. Zyra ka karakteristikat e nje shoqerie tregtare me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj bazohet kryesisht ne kete Statut dhe ne Aktin e Themelimit, ne dispozitat e Ligjit "Per Avokatine ne Republiken e Shqiperise" dhe Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

3.2 Zyra bazohet mbi parimet e ekonomise se tregut. Ajo ka per qellim qe te siguroje sherbim cilesor per klientet e saj si dhe te realizoje fitim nga ky aktivitet.

3.3 Personalitet juridik nga dita e aprovimit te saj nga Dhoma Kombetare e Avokatisë dhe regjistrimit perkates dhe regjistrimit sipasdispozitave te posacme Zyra fiton te Ligjit "Per Regjistrimin e Biznesit".

3.4. Ne perputhje me parashikimet ligjore mbi te cilat mbeshitet veprimtarine dhe rregullat e vendosura ne kete statut, Zyra mund te ndryshoje strukturen apo regjimin juridik te saj.

**II. TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE**

**NENI 4**  
**Te drejtat dhe detyrimet e ortakëve**

4.1. Ortaku(et) administrojne aktivitetin e Zyres ne perputhje dhe konform objektit te saj. Gjithashtu, ne perputhje me praktiken e mire, administrohen edhe vlerat intelektuale dhe ekonomiko-financiare te Zyres.

4.2. Ortaku(et) kane dijeni ne çdo kohe per gjendjen dhe rezultatin ekonomiko - financiar te Zyres dhe zoteron ne çdo kohe te gjithë dokumentacionin me interes te saj.

4.3. Ata ruajne te drejten qe ne çdo kohe te terhiqen nga pjesemarrja ne Zyre dhe te tjetersojne pjesen e tyre te kapitalit te investuar, ne perputhje me rregullat e ketij statuti dhe ligjin perkates.

4.4. Heqja dore nga shoqeria nuk i liron ortakët nga detyrimet qe kane deri ne çastin e heqjes dore dhe, nuk i ndalon ata ne marrjen e te ardhurave perkatese te siguruara nga shoqeria deri ne ate moment.

4.5. Ortaku(et) nuk mund te jene pjesemarres njekohesisht edhe ne Zyra te tjera Ligjore.



**NENI 5**  
**Pasurite e Zyres**

5.1. Pasurite e krijuara nga Zyra gjate aktivitetit te saj, jane ne pronesi te ortakeve ne perputhje me kapitalin themeltar te investuar prej tyre, apo me kontributin per çdo aktivitet te vecante te ushtruar prej Zyres.

5.2. Me miratim te Mbledhjes se Orakeve, (kur ajo eshte formuar) investimi i secilit ortak ne pasurine e Zyres mund te ndryshoje ne perputhje me nje gjendje te re te krijuar gjate aktivitetit.

5.3. Ortaku(et) mban pergjegjesi per humbjet e krijuara gjate ushtrimit te aktivitetit te tyre, deri ne kufirin e kontributit te investuar.

**NENI 6**  
**Kohezgjatja e Zyres Ligjore**

6.1. Veprimtaria e ZyresLigjore do te shtrihet ne nje afat te pakufizuar ne kohe. Ne rast mbarimi te aktivitetit te saj, Zyra do te ndjeke te gjitha procedurat e ngjashme qe aplikohen nga shoqerite tregtare per mbylljen e aktivitetit te tyre.

**III. KUSHTET EKONOMIKE TE ZYRES**

**NENI 7**  
**Burimet financiare**

7.1. Zyra krijon burimet e saj financiare nga ushtrimi i veprimtarise se saj sipas objektit te percaktuar.

7.2. Veprimtaria e funksionimit te Zyres bazohet ne kerkesat e ekonomise se tregut.

7.3. Veprimtaria ekonomike-financiare ndertohet mbi parimet e llogarise dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.



## *NENI 8*

### *Kapitali dhe kuotat e Shoqerise*

**8.1.** Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 lek, i ndare ne 4 (kater) Kuota, te cilat jane te shperndara ndermjet ortakeve si ne vijim:

**z. Arben RAKIPI**, zoteron 1 Kuote, e cila perben 55% te kapitalit dhe ka nje vlere nominale prej 55 lekesh.

**z. Jon RAKIPI**, zoteron 1 Kuote, e cila perben 10% te kapitalit dhe ka nje vlere nominale prej 10 lekesh.

**z. Ermir BETA**, zoteron 1 Kuote, e cila perben 20 % te kapitalit dhe ka nje vlere nominale prej 20 lekesh.

**Znj. Romina ZANO**, zoteron 1 Kuote, e cila perben 15% te kapitalit dhe ka nje vlere nominale prej 15 lekesh.

**8.2.** Per vertetimi e pronesise mbi kuotat e mesiperme, shoqeria tregtare mund te leshoje ne emer te personit apo te personave qe zoterojne kuoten, nje çertifikate per te vertetuar zoterimin e kuotes se kapitalit.

## *NENI 9*

### *Pasuria e Zyres*

**9.1.** Pasurite e Zyres perbehen nga sendet e kontribuar prej ortakut themelues z. Arben Rakipi, dhe nuk jane perfshire ne kapitalin themeltar te Zyres.

**9.2.** Ne çastin e aderimit te nje ortaku te ri ne Zyren Ligjore, vlere e pasurive te Zyres do te konsiderohet si kontribut i ortakut themelues dhe ne rast se me zhvillimin e aktivitetit do te krijohen pasuri te tjera, atehere ato do te konsiderohen qe jane ne bashkepronesi te ortakeve sipas vleres se kapitalit qe ata kane investuar.

## *NENI 10*

### *Transferimi i Kuotave*

**10.1.** Kuotat e kapitalit te regjistruar mund te transformohen, teresisht ose pjeserisht, tek te tretet, vetem me kontrate me shkrim dhe me miratimin e Asamblese se Ortakeve me shumice te cilesuar.



5

## *NENI 11*

*11.1.* Transferimi i mundshem i kuotave behet me akt noterial, perndryshe eshte i pavlefshem. Po me nje akt te tille merr formen edhe miratimi i ortakeve te Shoqerise per transferimin e kuotave.

## *NENI 12*

### *Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit*

*12.1.* Kapitali themelor mund te zmadhohet apo zvogelohet me vendim te ortakeve themelues ne nje mbledhje te vecante te asamblese se pergjithshme te ortakeve.

## *NENI 13*

### *Fondet Rezerve*

*13.1.* Zyra krijon fondin rezerve per te perballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare per shlyerjen e detyrimeve te krijuara nga veprimtaria e saj ekonomike.

## *NENI 14*

### *Perdorimi i te ardhurave*

*14.1.* Zyra mund t'u shperndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

*14.2.* E ardhura e krijuar nga aktiviteti i Zyres, pasi zbriten shpenzimet e bera dhe amortizimi i mjeteve te perdorura per cfaredolloj aktiviteti, pagesat per tatimet dhe taksat vendore, pagat apo shperblimet per punen e te punesuarve, asistenteve dhe bashkepunetoreve te tjere, pagesat e bera per rritjen e investimeve ne aktivitetin e Zyres, ndahen ndermjet ortakeve ne perputhje me kontributin e tyre.





**NENI 15**  
**Pasqyrat Financiare**

**15.1.** Te ardhurat dhe pasuria e Zyres vleresohet ne monedhe te vendit, ne perputhje me rezultatet e nxjerra nga ana e eksperteve kontabel te caktuar per te realizuar perpilimin e pasqyrave financiare.

**15.2.** Bilanci vjetor duhet te paraqitet brenda afateve te percaktuara nga legjistacioni tatimor. Forma e pasqyres financiare te Zyres, perputhet me formen e miratuar nga ekspertet ne Republiken e Shqiperise.

**IV. ORGANET E SHOQERISE**

**NENI 16**  
**Asambleja e Pergjithshme**

**16.1.** Organi kryesor i Shoqerise eshte Mbledhja e Asamblese se Ortakeve. Ajo eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme. Mbledhja e jashtezakonshme mund te mblidhet kur Ortaket apo Administratoret e Shoqerise e shohin te nevojshme te shqyrtojne nje ceshtje me rendesi te posaçme.

**16.2.** Mbledhja e Asamblese se Ortakeve mund te shqyrtoje e vendose per te gjitha ceshtjet, me perjashtim per ato qe statuti ka percaktuar ndryshe.

**16.3.** Mbledhja e Asamblese se Ortakeve mblidhet te pakten nje here ne 6 (gjashte) muaj. Administratori, ne rastet kur therret Mbledhjen, ben njoftimin 15 dite perpara, me shkrim, per secilin Ortak.

**16.4.** Ne Mbledhja mbahet procesverbal nga nje sekretar i caktuar nga administratori.

**16.5.** Vendimet e marra nga Mbledhja arrihen me shumice te cilesuar te votave te anetareve. Nese numri i votave eshte i barabarte, vendimet merren ne baze te peshes se kuotes qe ka secili ortak votues ne kuotat e kapitalit te shoqerise. Vendimet nenshkruhen nga Ortaket e Shoqerise, si dhe ruhen ne arkivin e Zyres. Vendimeve te marra, u nenshtrohen te gjithe ortaket dhe punonjesit e tjere te Zyres.



Three handwritten signatures in blue ink are present at the bottom of the page. The signatures are stylized and appear to be in Albanian. The first signature is on the left, the second is in the middle, and the third is on the right.



## NENI 17

### Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

17.1. Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- percaktimin e politikave te pergjithshme tregtare te Shoqerise ;
- te modifikojte dhe ndryshojte Statutin e Shoqerise ;
- emërimin apo shkarkimin e administratorëve;
- te percaktojte eksperte kontabel te miratuar apo likuiduesit e Shoqerise ;
- mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- te perfaqesojte Shoqerine ne Gjykate si dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- te riorganizojte dhe prishe Shoqerine ;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.


## NENI 18

### Kompetencat e Mbledhjes se Jashtezakonshme

18.1. Ne Mbledhjen e Jashtezakonshme te Asamblese mund te shqyrtohen dhe vendosen per ceshtje si me poshte :

- Miratimi i mbylljes se veprimtarise se Zyres;
- Miratimi i shtimit/pakesimit te numrit te Ortakeve te Zyres;
- Miratimi i fillimit te procedurave per falimentimin e veprimtarise se Zyres;
- Miratimin e shtimit te aktivitetit ne fushat jashte veprimtarive ligjore dhe regjistrimet perkatese sipas ligjit Per Shoqerite Tregtare.

18.2. Mbledhja e jashtezakonshme thirret vetem nga Ortaket. Ajo ndjek, per aq sa perputhen, te njejtat rregulla me Mbledhjen e zakonshme.



8

**NENI 19**  
**Ortaket e Rinj**

**19.1.** Mbledhja e jashtezakoneshme e Ortakeve mund te lejoje mbi baze unanimiteti pranimin e ortakeve te rinj.

**19.2.** Kriteret e pranimit teortakeve te rinj percaktohen rast pas rasti nga Ortaket Themelues, apo edhe Ortaket e bashkuar me vone atyre. Per çdo rast vleresohen cilesite profesionale te kandidatit, fusha e veprimtarise kryesore te tij, kontributi ne mbarevajtjen e puneve te deri atehershme te Zyres, reputacioni publik i tij dhe te tjere kriteret te vendosura nga Mbledhja e Ortakeve.

**19.3.** Ne rast te shtimit te Ortakeve te rinj, rregullohen edhe marredheniet ekonomike ndermjet tyre, kuotat dhe kontributi, te cilat pasqyrohen menjehere ne statut.

**V. ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

**NENI 20**  
**Administratori**

**20.1.** Administrimi i Zyres do te kryhet nga administratori ose administratoret e Shoqerise. Ata kane te drejtat per drejtimin e zakonshem te Zyres, pervec atyre te drejtave qe Ligji apo ky statut ja kalon Ortakeve te tjere te Shoqerise.

**20.2.** Administratori/Administratoret perfaqesojne zyren ne marredhenie me te tretet si dhe perpara organeve te administrates shteterore apo ato gjyqesore.

**20.3.** Administratoret emerohen apo shkarkohen nga detyra e tyre me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

**20.4.** Administratoret mund te jene pergjegjes civilisht per demet qe mund te shkaktojne gjate kryerjes se detyres.

**20.5.** Administratoret pergjigjen ne menyre te barabarte perpara Ortakeve per punen e tyre dhe u krijojne atyre akses ne cdo dokumentacion apo pune te Zyres, kur kerkohet prej tyre.



20.6. Administratori i pare i Zyres Ligjore “*Rakipi & Partners*” (*R&P*), deri ne zgjedhjen e nje administratori te posaçem te Zyres, do te jete z. *Ermir Beta*, per nje afat 3-vjeçar duke filluar nga momenti i nenshkrimit te ketij Statuti dhe Akti Themelimi.

20.7. Administratori gezon kompetenca te pakufizuara per realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise, me perjashtim te atyre kompetencave qe Statuti ia njeh Asamblese se Pergjithshme.

#### **NENI 21**

##### ***Kompetencat e Administratorit***

21.1. Administratori ka keto kompetenca kryesore :

- a. te miratoje planin e veprimtarise se Zyres dhe te paraqese ate per miratim ne Mbledhjen e Ortakeve;
- b. te rekomandoje ndryshime ne kapitalin themeltar;
- c. te rregulloje me akte detyruese raportet e punes brenda Zyres;
- d. te perfaqesoje Zyren ne marredhenie me te tretet;
- e. te percaktoje strukturen e organizimit te Zyres dhe perpiqet per perzgjedhjen e pjestareve te saj, jo ortake;
- f. te grumbulloje ne menyre te vazhdueshme dhe periodike te gjitha materialet teorike apo te jurisprudences qe lidhen drejtpersedrejti me mbarevajtjen e puneve ne Zyre;
- g. te organizoje manuale mbi kriteret e punesimit dhe testimet profesionale per te gjitha kandidatet qe kerkojne te punojne ne Zyre;
- h. te gjitha detyrat e tjera qe i ngarkohen nga Mbledhja e Ortakeve.

#### **NENI 22**

##### ***Eksperti Kontabel***

22.1. Ortaket caktojne ekspert kontabel per çdo vit financiar. Ai mban pergjegjesi per mirembajtjen e te gjitha llogarive te Zyres.

22.2. Detyra e ekspertit kryhet nga persona te autorizuar nga ligji per veprimtari te tilla.



10

## **VI. MARREDHENIET E PUNES**

### **NENI 23**

#### **Punesimi**

23.1. Marredheniet e punes ne Zyre rregullohen nga kontrata individuale e punes, rregullat e ketij statuti dhe Kodi i Punes.

23.2. Administratori i Zyres percakton kriteret per punesimin e avokateve te rinj, asistente avokateve dhe punonjeseve te tjere teknike te Zyres.

### **NENI 24**

#### **Kontrata Individuale e Punes**

24.1 Kontrata individuale e punes duhet te rregulloje :

- Marrjen ne pune dhe kushtet e saj;
- Llojin e punes qe do te kryhet, profesionet ndihmese, koha e punes ditore dhe javore, pushimet, shperblimin per kohen e punes ( mujor), shperblimin per kohen jashte orarit te punes, festave, diteve te pushimit, bonuset per pune cilesore;
- Rregulla mbi konfidencialitetin e punes, rregulla te etiketave se punes dhe ate te marrdhenijeve me gjykatat apo institucione te tjera;
- Pergjegjesitee paleve per cenimin e kontrates se punes dhe rregullave te gjithe pranuar te punesimit.


### **NENI 25**

25.1 Te punesuarit mbajne pergjegjesi civile kur ata, me veprimet e tyre, i shkaktojne nje dem pasuror Zyres.

## **VII. MBYLLJA E VEPRIMTARISE SE ZYRES. LIKUIDIMI**

### **NENI 26**

26.1. Veprimtaria e Zyres mund te mbyllet ne cdo kohe me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.



11



**NENI 27**

27.1. Kur Asambleja e Ortakeve merr vendimin per mbylljen e veprimtarise, caktohet nje likuidator. Ne keto raste perkrah emrit te Zyres, shenohen edhe fjalet "ne likuidim".

27.2. Me miratimin e likuidimit, Zyra i jep fund veprimtarise.

**NENI 28**

28.1. Ortaket vendosin mbi rregullsine e likuidimit, bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit te likujduesit.

28.2. Kur jane kushtet e kerkuara nga Ligji perkates, Gjykata mund te vendose per mbylljen e likuidimit me kerkese te çdo te interesuari.

28.3. Aktet e mbylljes depozitohen ne regjistrin e Dhomes Kombetare te Avokatise dhe Qendres Kombetare te Biznesit.

**VIII. DISPOZITA TE FUNDIT**

**NENI 29**

29.1. Ky Statut dhe Akt Themelimi hyn ne fuqi mbas miratimit dhe regjistrimit te Zyres ne Regjistrin e Dhomes Kombetare te Avokatise, si dhe ne momentin e regjistrimit te saj prane Qendres Kombetare te Biznesit.

*Ortaket themelues*

Acc. z. **Arben RAKIPI**



**Av. Jon RAKIPI**



**Av. Ermir BETA**



**Av. Romina ZANO (Lleshi)**

